



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 qershor 2019  
Nr. ref.: RK 1381/19

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI164/18**

Parashtrues

**Limak Kosovo International Airport J.S.C, "Adem Jashari"**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 217/2018, të 6 shtatorit 2018**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport J.S.C, "Adem Jashari" (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, Komuna e Lipjanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë Fazli Gjonbalaj dhe Leonora Fejzullahu.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 217/2018, të 6 shtatorit 2018.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues) Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, në rastin KI128/18.
6. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës përmes Urdhrit i bashkoi rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18 dhe KI132/18, me gjyqtarin raportues dhe Kolegjin shqyrtues të njëjtë si në rastin KI128/18.
7. Më 25 tetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) dhe rasti është regjistruar me numër KI164/18.
8. Më 5 nëntor 2018, Kryetarja e Gjykatës përmes Urdhrit i bashkoi rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18 dhe KI132/18, me rastet KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18, me gjyqtarin raportues dhe Kolegjin shqyrtues të njëjtë si në rastin KI128/18.
9. Më 8 nëntor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesave KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 dhe për bashkimin me rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18 dhe KI132/18, dhe i dërgoi kopjet e kërkesave të bashkuara Gjykatës Supreme.
10. Më 4 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës përmes Urdhrit i ndau rastet e bashkuara KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 në rastet individuale, me gjyqtarin raportues dhe Kolegjin shqyrtues të njëjtë si në rastin KI128/18.

11. Më 12 prill 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme se rastet KI128/18, KI129/18, KI130/18, KI132/18, KI164/18, KI165/18, KI166/18 dhe KI167/18 janë ndarë përmes Urdhrit dhe se ato do të shqyrtohen veç e veç para Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 12 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë të titulluar “[...]lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese DHE në veçanti për lëndën e regjistruar me [...] numër KI132/18”.
13. Më 16 maj 2019, parashtruesi i kërkesës përsëri dërgoi një shkresë të titulluar “Parashtruesi, lidhur me lëndët e regjistruara në Gjykatën Kushtetuese”, në të cilën ai në thelb i përsëriti pretendimet që kishte bërë më parë.
14. Më 27 maj 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve të rastit**

15. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës nënshkruan Marrëveshjen e Partneritetit Publiko-Privat (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja e PPP-së). Para nënshkrimit të Marrëveshjes së PPP-së, emri i Aeroportit të Prishtinës ishte Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (në tekstin e mëtejme: ANP).
16. Në bazë të shkresave të lëndës, vërehet se punëtori F.S. (në tekstin e mëtejme: punëtori) ka qenë i punësuar në ANP. Në bazë të Marrëveshjes së PPP-së, parashtruesi i kërkesës mori përsipër obligimin për t’i mbajtur të gjithë punëtorët në marrëdhënie të punës për 3 (tri) vjet.
17. Punëtori ka qenë në marrëdhënie të rregullt të punës tek parashtruesi i kërkesës në periudhën prej 4 prillit 2011 deri më 3 prill 2014.
18. Më 3 mars 2014, përkatësisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës, parashtruesi i kërkesës e njoftoi punëtorin se “...në pajtim me politikën e Bordit të Drejtorëve dhe Ligjin e punës të Kosovës, si dhe vendimin për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore [...] nuk do t’i vazhdohet Kontrata e Punës pas datës 03.04.2014”.
19. Më 11 mars 2014, punëtori paraqiti ankesë tek parashtruesi i kërkesës “...me propozim që njoftimi për mospërfitje të kontratës së punës i dt. 03.03.2014, të anulohet si joligjor dhe paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës”.
20. Më 20 mars 2014, parashtruesi i kërkesës refuzoi, si të pabazuar, ankesën e punëtorit.
21. Punëtori paraqiti kërkesëpadinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), duke kërkuar që të anulohet njoftimi i 3 marsit 2014 i nxjerrë nga parashtruesi i kërkesës dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës ta kthejë punëtorin në punë me të gjitha të drejtat dhe obligimet, si dhe t’ia kompensojë dëmin material të pësuar.

22. Më 2 qershor 2015, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit (C. nr. 203/2014) e (i) aprovoi kërkesëpadinë e punëtorit si të bazuar, (ii) anuloi njoftimin e parashtruesit të kërkesës të 3 marsit 2014, si dhe përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të 20 marsit 2014 për mospërtrirjen e kontratës së punës, (iii) obligoi parashtruesin e kërkesës që ta kthejë punëtorin në vendin e njëjtë të punës, (iv) obligoi parashtruesin e kërkesës që t'ia paguajë punëtorit një shumë të caktuar në emër të dëmit material dhe (v) obligoi parashtruesin e kërkesës që t'i mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.
23. Më 31 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit (C. nr. 203/2014) të Gjykatës Themelore, duke theksuar se Aktgjykimi i kontestuar është marrë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe se ekziston vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dhe aplikimi i gabuar i së drejtës materiale.
24. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij në thelb theksoi se Gjykata Themelore ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike sa i përket kohëzgjatjes së përvojës së punës të punëtorit, duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vite përvojë pune. Parashtruesi i kërkesës konsideron se për shkak të vërtetimit të tillë të gabuar të gjendjes faktike është bërë zbatimi i gabuar i së drejtës materiale dhe procedurale dhe se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është në kundërshtim me nenin 9.18 të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko-Privat, të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe kompania Limak Kosovo International Airport, të 12 gushtit 2010.
25. Më 19 mars 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (CA. nr. 3433/2015) refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin (C. nr. 203/2014) e Gjykatës Themelore, duke konsideruar se i njëjti është i drejtë dhe i ligjshëm dhe duke theksuar se gjykata e shkallës së parë kishte dhënë arsye konkrete për faktet vendimtare dhe ofruar shpjegime të duhura për një vendim të tillë në bazë të dispozitave relevante ligjore.
26. Më 11 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke pretenduar se ka pasur shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se gjykatat e shkallës më të ulët nuk e morën për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas të cilit parashtruesi i kërkesës merr përsipër obligimin që punëtorët t'i mbanë në punë për 3 (tri) vite. Për më tepër, parashtruesi pretendon se „*gjykata e bëri bashkimin e përvojës së punës nga dy punëdhënës të ndryshëm*“.
27. Më 6 shtator 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev. nr. 217/2018 refuzoi, si të pabazuar, revizionin e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin vijues: „*...Duke shqyrtuar thëniet e revizionit se aktgjykimi i goditur përmban shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, të cilat sipas revizionit kanë të bëjnë me atë se aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e dhëna janë kundërthënëse me arsyetimin në përgjithësi, gjykata e revizionit konstaton se këto thënie e revizionit janë të pabazuara, nga fakti se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike të cilat janë të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosje sipas ankesës së të paditurës, ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, për të njëjtat ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat janë të pranuar edhe nga gjykata e revizionit*“.

## Pretendimet e parashtruesit

28. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se “Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev. nr. 217/2018 [...] ka shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], për shkak të mos arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke pohuar më tej se „si pasojë e mungesës së arsyetimit, vendimi i kontestuar e privoi parashtruesin e kërkesës nga e drejta kushtetuese për mjet efektiv juridik” dhe me këtë atij i është shkelur edhe e drejta e garantuar kushtetuese me nenin 32 dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit], e si pasojë e këtyre shkeljeve, parashtruesit i është cenuar edhe e drejta e pronës sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi pohon gjithashtu, se ka shkelje të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së”.
29. Parashtruesi i kërkesës në thelb e arsyeton kërkesën e tij duke theksuar se gjykatat e rregullta e kishin vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe se e drejta procedurale dhe materiale është aplikuar gabimisht, duke theksuar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme çështjet në vijim:
- (i) Se gjykatat e rregullta e vërtetuan gabimisht gjendjen faktike sa i përket kohëzgjatjes së përvojës së punës së punëtorit, duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vite përvojë pune;
  - (ii) Se parashtruesi kishte të drejtën të ndërpriste me njoftim marrëdhënien e punës në pajtim me kontratën e punës, neni 1.1 dhe me nenin 67 paragrafi 1.3, si dhe me nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212;
  - (iii) Se gjykatat e rregullta e interpretuan gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, për arsye se ai nuk mund të aplikohet për kompaninë Limak, ngase punëtori nuk kishte dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprere tek i padituri;
  - (iv) Se gjykatat e rregullta nuk e morën për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas së cilit, parashtruesi i kërkesës merr përsipër obligimin që punëtorët t'i mbanë në punë për një afat prej 3 (tri) vitesh.
30. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu citon Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15 dhe thekson se “zbatimi i të drejtës materiale, që mund të ishte një fakt, ka qenë faktor vendimtar për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate, por Gjykata Supreme nuk e zgjidhi fare këtë çështje, por vetëm konstatoi se gjykatat e shkallës më të ulët i zbatuan drejtë dispozitat e të drejtës materiale”.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “Gjykata Kushtetuese duhet të vlerëson nëse procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës (shih, ndër të tjera, mutatis mutandis, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 dhjetor 1992, f. 34, seria A, nr. 247 dhe B. Vidal kundër Belgjikës, 22 prill 1992, f. 33, seria A, nr. 235).
32. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe ta kthejë çështjen në rigjykim.

## Dispozitat përkatëse ligjore

### Ligji i Punës nr. 03/L-212

#### Neni 10 Kontrata e Punës [...]

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

#### Neni 67 [Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:  
[...]  
1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës.

#### Neni 70 [Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

- 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;
- 1.2. i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;
- 1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;
- 1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:
  - 1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe
  - 1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës;
- 1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;
- 1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:
  - 1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;
  - 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;

1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

## **Marrëveshja e Partneritetit Publiko-Privat për Operim dhe Zgjerim të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës**

### **9.18 [Përfundimi i Personelit]**

*„Partneri privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të gfarëdo punëtori të ANP-së (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara, (ii) sipas marrëveshjes së përbashkët dhe (iii) pa kufizime, pas përvjetorit të tretë (3) të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje“.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113. [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

35. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

36. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të parashtrojë ankesë kushtetuese, duke iu referuar të drejtave që vlejné për individë, por edhe për

persona juridik (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës: *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

37. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.  
2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

38. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur me vendimet e cekura, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe e dorëzoi kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
39. Megjithatë, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton se:

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

40. Fillimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, ndërsa shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me



Kushtetutë dhe KEDNJ parashtruesi i paraqet si pasojë e shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

41. Parashtruesi i kërkesës në thelb e arsyeton kërkesën e tij duke përsëritur të njëjtat pretendime që ai kishte paraqitur edhe para gjykatave të rregullta, e të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar e së drejtës procedurale dhe materiale, duke theksuar se vendimet e gjykatave të rregullta nuk i arsyetuan mjaftueshëm çështjet vijuese:
- (i) Se gjykatat e rregullta e vërtetuan gabimisht gjendjen faktike sa i përket kohëzgjatjes së përvojës së punës së punëtorit, duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vite përvojë pune;
  - (ii) Se parashtruesi kishte të drejtën të ndërpriste me njoftim marrëdhënien e punës në pajtim me kontratën e punës, neni 1.1 dhe me nenin 67 paragrafi 1.3, si dhe me nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212;
  - (iii) Se gjykatat e rregullta e interpretuan gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, për arsye se ai nuk mund të aplikohet për kompaninë Limak, ngase punëtori nuk kishte dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprere tek i padituri;
  - (iv) Se gjykatat e rregullta nuk e morën për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas së cilit, parashtruesi i kërkesës merr përsipër obligimin që punëtorët t'i mbanë në punë për një afat prej 3 (tri) vitesh.
42. Gjykata do të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të kontestuarra të gjykatave të rregullta në lidhje me pretendimin e parashtruesit se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, duke iu referuar secilit pretendim individual të parashtruesit.
43. Së pari, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se (i) gjykatat e rregullta e vërtetuan gabimisht gjendjen faktike sa i përket kohëzgjatjes së përvojës së punës së punëtorit, duke pretenduar se punëtori nuk ka më shumë se 3 vite përvojë pune.
44. Lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore ka arsyetuar se *“mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara si më lartë, e të cilave gjykata në tërësi iu fali besimin, është vërtetuar se paditësi tek paraardhësja e të paditurës ANP „Adem Jashari“ sh.a., ka themeluar marrëdhënie pune që nga dt. 06.01.2004 dhe tek e njëjta ka punuar pandërprerë deri më 03.04.2011, ndërsa që nga 04.04.2011 e deri më 03.04.2014, në mënyrë të pandërprerë ka punuar tek e paditura dhe me këtë ka plotësuar mbi 10 vite pune të pandërprerë tek paraardhësja e të paditurës dhe tek e paditura, e bazuar në dispozitën e nenit 10.5 të Ligjit të Punës, gjykata erdhi deri tek përfundimi se marrëdhënia e punës në kohë të caktuar tek e paditura, konsiderohet marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, andaj gjykata konsideron se në këtë situatë, e paditura për me ja shkëput marrëdhënien e punës në kohë të pacaktuar paditësit, ka qenë i obliguar që të udhëheqë procedurë të brendshme për ndërprerje të marrëdhënies së punës, procedurë kjo e cila nuk është udhëhequr tek e paditura, por paditësi vetëm është njoftuar me njoftimin për mospërtrirjen e kontratës së punës“.*
45. Së dyti, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (ii) se parashtruesi kishte të drejtë të ndërpriste me njoftim marrëdhënien e punës në pajtim me kontratën e punës, neni 1.1 dhe me nenin 67 paragrafi 1.3, si dhe me nenin 71 paragrafi 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

46. Lidhur me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore ka konkluduar së pari se “... njoftimi i të paditurës për mospërtrirjen e kontratës së punës paditësit, pa zhvilluar asnjë procedurë të brendshme për ndërprerje të marrëdhënies së punës është joligjor”.
47. Më tej, Gjykata Themelore me të njëjtin Aktgjykim arsyetoi se kur dhe në cilat kushte punëdhënësi mund ta shfrytëzojë këtë mundësi, duke arsyetuar hollësisht se cilat masa paraprake juridike duhet t’i ndërmerret, duke theksuar si në vijim: “...nëse ndërprerja e marrëdhënies së punës ka të bëjë me arsyet teknike, ekonomike ose organizative, konform dispozitave të nenit 70 e lidhur me nenin 76 të Ligjit të Punës, e paditura ka qenë e obliguar të harton program me shkrim si dhe të zbatoj këto dispozita të LP, dhe përveç që ta njoftoj paditësin një muaj para se të ia ndërpres marrëdhënien e punës, ka qenë i obliguar edhe ta njoftoj sindikatën e të punësuarve lidhur me ndryshimet e planifikuar, duke bërë përpjekje paraprakisht për risistemimin e brendshëm të të punësuarve, kufizimin e orëve jashtë orarit të punës, zvogëlimin e orëve të punës së punëtorëve, ofrimin e riaftësimin profesional dhe masat tjera të përcaktuara me ligj, masa këtë to cilat asnjërën prej këtyre nuk e ka bërë e paditura, përkatësisht deri në përfundimin e procedurës nuk ka ofruar prova se ka vepruar diçka në këtë drejtim”.
48. Së treti, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (iii) se gjykatat e rregullta e interpretuan gabimisht nenin 10.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, për arsye se ai nuk mund të aplikohet për kompaninë Limak, ngase punëtori nuk kishte dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprere tek i padituri.
49. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit arsyetoi se “...nga provat e administruara padyshim rezulton se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në një periudhë më të gjatë se 10 vjet, dhe se në rastin konkret në kuptim të nenit 10 par. 5 të Ligjit për Punën do të konsiderohet se është fjala për marrëdhënien e punës në kohë të pacaktuar. Në rastin konkret nuk ka vend për aplikim të nenit 67 par. 1 pika 3 të Ligjit për Punën me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, por duhet të aplikohet neni 71 par. 1 pika 3 të njëjtit Ligj”.
50. Së katërti, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës (iv) se gjykatat e rregullta nuk e morën për bazë nenin 9.18 të Marrëveshjes së PPP-së, sipas së cilit, parashtruesi i kërkesës merr përsipër obligimin që punëtorët t’i mbanë në punë për një afat prej 3 (tri) vitesh.
51. Gjykata vëren se Gjykata Supreme arsyetoi se “... i vlerësoi edhe thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë nuk kanë marrë për bazë faktin ligjor dhe atë të nenit 9.18 të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kompania Private „Limak“ të datës 12.8.2010, në bazë të kësaj marrëveshje Kompania „Limak“ merr obligim që punëtorët t’i mban në punë për 3 vite, ku pas kësaj periudhe nuk mbart asnjë përkufizim pas përvjetorit të tretë të datës së hyrjes në fuqi të kontratës së punës, dhe gjykata i vlerëson si të pabazuara pasi që e paditura ka vazhduar subjektivitetin e ish Aeroportit të Prishtinës duke marrë përgjegjësinë ndaj punëtorëve të Aeroportit dhe se nuk ka asnjë arsye ligjore dhe se e paditura ka mundur ta ndërprejë marrëdhënien e punës vetëm në kushtet e parapara me nenin 70 të Ligjit të Punës e kurrësi në bazë të nenit 67.1 dhe 3 të këtij Ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës. Në rastin konkret me njoftim, ashtu siç ka vepruar e paditura, nuk ka pas mundësi që paditësit të mos i vazhdohet kontrata e punës ku kontrata e tij e punës konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar”.

52. Më tej, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës i referohet edhe Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KI138/15 dhe pretendon se “zbatimi i të drejtës materiale, që mund të ishte një fakt, ka qenë faktor vendimtar për marrjen e aktgjykimit të asaj gjykate, por Gjykata Supreme nuk e zgjidhi fare këtë çështje, por vetëm konstatoi se gjykatat e shkallës më të ulët i zbatuan drejtë dispozitat e të drejtës materiale”.
53. Sa i përket këtij pretendimi të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se rasti i përmendur dallon nga rasti i cili gjendet para nesh, për shkak të këtij arsyeimi: (i) çështja e procedurës disiplinore kundër të punësuarit tek parashtruesi i kërkesës në atë rast është shqyrtuar në mënyrë të ndryshme nga gjykatat e rregullta; (ii) nuk ka qenë e qartë baza juridike, sipas së cilës është zhvilluar procedura disiplinore; (iii) kanë ekzistuar elementet kontradiktore në vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit e aplikoi dhe shfrytëzoi për arsyeim Udhëzimin Administrativ i cili zbatonte Rregulloren për Shërbimin Civil, e jo Ligjin e Punës. Ky argument, edhe pse është ngritur nga parashtruesi në këtë rast, nuk është shqyrtuar nga Gjykata Supreme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI138/15, *Sharr Beteiligung GmbH*, Aktgjykim i 4 shtatorit 2017).
54. Gjykata përsërit në radhë të parë se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet që lidhen me gjendjen faktike apo me aplikimin e gabuar e të drejtës, që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç nëse gabimet dhe aplikimi i gabuar i së drejtës nuk janë të tillë sa të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë të jenë shkelur (shih rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, Aktgjykimin e 21 janarit 1999, paragrafi 28).
55. Gjithsesi, gjykatat e rregullta në radhë të parë janë të detyruara të zgjidhin problemin e interpretimit të rregulloreve ligjore të vendit. Kjo veçanërisht ka të bëjë me interpretimin e rregullave të natyrës procedurale nga gjykatat (shih rastin e GJEDNJ-së *Pekinel kundër Turqisë*, nr. 9939/02, 18 mars 2008, paragrafi 53). Roli i Gjykatës është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në pajtim me Kushtetutën në tërësi dhe me parimin e sigurisë juridike, të garantuar veçanërisht me nenin 6 të KEDNJ-së.
56. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës obligojnë gjykatat që të argumentojnë arsyet për aktgjykimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për të dhënë përgjigje të detajuar për çdo argument të parashtruesit (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, Seria A, nr. 288, f. 20, paragrafi 61). Shkalla në të cilën Gjykata do të përmbushë obligimin për t'i argumentuar arsyet mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Atëherë gjithashtu duhet të merret parasysh, *inter alia*, se shumëllojshmëria e parashtrësive të paraqitura nga palët në procedurë mund të rezultojë me atë që gjykatat të japin mendime dhe përfundime të ndryshme juridike gjatë hartimit të aktgjytimeve. Prandaj, çështja nëse gjykata e ka përmbushur obligimin për të argumentuar arsyet për vendimin e saj, i cili rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të secilit rast individual.
57. Gjykata rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës, t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij, e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe

shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, prandaj, procedura, shikuar në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).

58. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është shkelur me vendimet e autoriteteve publike.
59. Duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk arriti të paraqesë prova, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta e kishin shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata nuk do të merret me shqyrtimin e pretendimeve të mëtejshme të parashtruesit të kërkesës për shkak se shkeljet e të drejtave të tjera të garantuara me nenet 24, 32 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, nga parashtruesi i kërkesës paraqiten si pasojë e shkeljes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
60. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
61. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (2) të Rregullores së punës, më 27 maj 2019, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Radomir Laban



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi